

VENDIM
Nr.840, datë 17.12.2004

PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK
(Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 15.9.2006; nr. 407, datë 18.6.2014; nr. 562, datë 8.10.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik (DSHTD) është person juridik, publik, në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”.

2. Objekti i veprimtarisë së DSHTD-së është:

a) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

b) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, pronë e shtetit shqiptar në shtete të tjera, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

c) *Mirëmbajtja e godinës, ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe përmirësimi i inventarit material të kësaj ministrie.*

3. Të njëjtat shërbime, që DSHTD-ja kryen për trupin diplomatik, mund t’ua ofrojë edhe subjekteve, shtetërore ose private, shqiptare, si veprimtari dytësore, por që i shërbejnë objektit kryesor të veprimtarisë së saj. Në çdo rast, ushtrimi i këtyre veprimtarive në favor të këtyre subjekteve nuk duhet të pengojë apo cenojë shërbimin ndaj trupit diplomatik.

3/1. Përcaktimi i çmimeve dysHEME të qirasë, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik zbaton për subjektet shqiptare jodiplomatike, dhe procedurat përkatëse bëhen në përputhje me aktet, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, për përcaktimin e tarifave të qirasë për objektet e ndërmarrjeve shtetërore.

4. *Për të krijuar, garantuar dhe përmirësuar kushtet e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Trupit Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera apo pranë organizatave ndërkombëtare, DSHTD-ja përdor burimet e veta financiare. Gjithashtu, DSHTD-ja përballon me fondet e saj, tërësisht apo pjesërisht, shpenzimet për ndërtimin apo blerjen e objekteve të reja, pronë e shtetit shqiptar, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.*

5. Burimet financiare të DSHTD-së janë:

a) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për trupin diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

b) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të treta, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

c) Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;

ç) Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna të cilat përdoren vetëm në funksion të

veprimtarisë kryesore të DSHTD-së.

6. *Kapitali themeltar i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik është 1 586 848 843 (një miliard e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë.*

Bilanci financiar i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik miratohet, në fund të çdo viti financiar, nga këshilli drejtues, së bashku me raportin e auditimit nga ekspertët kontabël të pavarur.

7. Veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHTD-së kontrollohet nga organet përkatëse, të ngarkuara me ligj. Po ashtu edhe *Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare* ka të drejtë të udhërojë ushtrimin e kontrolleve, të plota ose të pjesshme, për veprimtarinë e DSHTD-së, nëpërmjet strukturave të specializuara.

8. *Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për Trupin Diplomantik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe, dhe miratohen për çdo vit financiar, nga këshilli drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.*

9. Ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe Bashkia e Tiranës, nëpërmjet strukturave dhe ndërmarjeve të tyre vartëse, sigurojnë me përparësi shërbime cilësore për mjediset që administrojnë DSHTD-ja, veçanërisht për furnizimin me energji elektrike, ujë, ndërlidhje telefonike, pastrim etj., në funksionin të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

10. Mënyra e organizimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së DSHTD-së, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre, përcaktohen në statutin, që miratohet nga *Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare*.

10/1 Ngarkohet drejtori i Shërbimit të Trupit Diplomantik të bëjë regjistrimin në gjykatë, në përputhje me ligjet nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” dhe nr.7667, datë 28.7.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, dhe të kryejë regjistrimin e listës së inventarit të pronave, të dhëna në përgjegjësi administrimi, në mbështetje të vendimit nr.450, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.

11. *Vendimi nr. 113, datë 26.2.1993 i Këshillit të Ministrave “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”, dhe aktet e tjera, të nxjerra në zbatim të tij, shfuqizohen.*

12. *Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe institucionet e përmendura në pikën 9 të vendimit në fuqi, për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano